

Kur SHBA-ja dhe Kuba i prenë lidhjet më 1961-shin, Zvicra u ftua për të kryer rolin e “fuqisë mbrojtëse” të interesave të SHBA-së në Kubë dhe anasjelltas.

Megjithëse numri i mandateve është pakësuar me kalimin e kohës, roli i Zvicrës si përfaqësuese e interesave të vendeve të huaja, mbetet i rëndësishëm

Dossier



Udhëheqësi kuban Fidel Castro në diskutime me ambasadorin e Konfederatës Helvetike, Emil Stadelhofer në vitin 1964

Roli përfaqësues i Zvicrës në marrëdhëniet SHBA – Kubë

Ambasadori Stadelhofer mbrojti fizikisht ambientet, kyçi dyert dhe u tha zyrtarëve kubanë se kjo ishte pronë diplomatike dhe mund të dhuohej vetëm mbi trupin e tij. Zyrtarët

e Castro-s u tërhoqën dhe ndërtesa e ambasadës amerikane mbeti nën kujdestarinë e autoriteteve zvicerane. Një tjetër detyrë e madhe për diplomatët zviceranë ishte organizimi i largi-

mit të një numri të madh të refugjatëve kubanë, të cilët Castro i lejoi të niseshin për në SHBA. Gjatë vitit 1965, 9268 shtetas kubanë u transportuan përmes detit dhe ajrit për në Florida, SHBA. Zyrtarët



e ambasadës zvicerane intervistuan, dokumentuan dhe qartësuan secilin prej tyre, para nisjes.

Procesi vazhdoi deri më 1973-shin dhe deri atëherë, 260 737 refugjatë kubanë kishin hyrë në Shtetet e Bashkuara përmes kësaj mënyre.

Sipas diplomatit dhe akademikut amerikan, Wayne S. Smith, “asnjë fuqi mbrojtëse më parë ose më pas, nuk ka mbajtur mbi supe një barrë më të rëndë”.

Ndërhyrje si kjo vazhduan intensivisht deri në vitin 1977, kur një njësi e quajtur Seksioni i Interesave të SHBA-së, u ngrit në ambasadën zvicerane në Havanë, e cila i lejonte disa zyrtarë amerikanë të punonin me çështjet administrative. Sidoqoftë, negociatorët dhe diplomatët zviceranë vazhduan të mbajnë një rol përfaqësues deri më 20 korrik 2015, kur më në fund, të dyja vendet vendosën marrëdhëniet diplomatike në Uashington dhe Havanë.

Përfaqësimi zviceran i interesave të SHBA-së në Kubë dhe gjithashtu i interesave kubanë në SHBA, është mandati më i gjatë i një fuqie mbrojtëse në histori. Ajo që e bënte rolin zviceran të veçantë, ishte se ai kryhej në mes të frikërave të një lufte të re botërore; përfshinte situata urgjente dhe kërkonte aftësi dhe veprime të forta nga diplomatët zviceranë.

Tradicional ishte roli i një fuqie mbrojtëse që kufizohet të përpunimi i vizave e dokumenteve dhe i përcimit të ndonjë mesazhi diplomatik.

Por ekspertët bien dakord se përfaqësimi zviceran i interesave ameri-

Gjatë Luftës së Ftohtë, kurdo që rriteshin tensionet ndërkombëtare, Zvicra shpesh thirrej që të vepronte si fuqi mbrojtëse për vende të ndryshme. Aktualisht, autoritetet zvicerane janë fuqi mbrojtëse për SHBA-në në Iran, për Iranin në Egjipt, për Rusinë në Gjeorgji dhe anasjelltas

kane në Kubë dhe anasjelltas, shkonte përtej detyrave të zakonshme burokratike dhe përfshinte shumë porosi të pazakonshme.

Zvicra neutrale ka vepruar për herë të parë si një fuqi mbrojtëse për vendet e tjera në fund të shekullit të 19, kur u kujdes për interesat e Mbretërisë së Bavarisë dhe Dukatit të Badenit në Francë, të cilët ishin në luftë me njëri-tjetrin gjatë luftës Franko-Prusiane të viteve 1870-1871.

Në Luftën e Parë Botërore, Zvicra pati 36 mandate mbrojtëse dhe gjatë Luftës së Dytë Botërore, përfaqësoi interesat e 25 vendeve. Kjo ishte koha kur Seksioni i Interesave të Huaja, ishte zyra më e madhe në Departamentin zviceran të Punëve të Jashtme në Bernë.

Gjatë Luftës së Ftohtë, kurdo që rriteshin tensionet ndërkombëtare, Zvicra shpesh thirrej që të vepronte si fuqi mbrojtëse për vende të ndryshme. Aktualisht, autoritetet zvicerane janë fuqi mbrojtëse për SHBA-në në Iran, për Iranin në Egjipt, për Rusinë në Gjeorgji dhe anasjelltas.

Megjithëse numri i mandateve është pakësuar me kalimin e kohës, roli i Zvicrës si përfaqësuese e interesave të vendeve të huaja, mbetet i rëndësishëm.

Ndërsa sekretari amerikan i Shtetit, John Kerry, bëri histori gjatë vizitës në Kubë të premtën në datë 14 gusht për të rihapur ambasadën e SHBA-së në Havanë, një fakt i panjohur del në pah. Kur SHBA-ja dhe Kuba i prenë lidhjet më 1961-shin, Zvicra u ftua për të kryer rolin e “fuqisë mbrojtëse” të interesave të SHBA-së në Kubë dhe anasjelltas.

Autoritetet zvicerane morën përsipër interesat amerikane në këtë ishull dhe punuan përmes shumë sfidave diplomatike në vitet që pasuan.

Emërimi i Zvicrës si fuqi mbrojtëse erdhi papritur. Kjo nuk ishte një detyrë dosido. Revolucioni i udhëhequr nga Castro, sapo kishte shtetëzuar bizneset dhe pronat amerikane në Kubë dhe kërcënimi i luftës ishte i kudondodhur.

Diplomatët zviceranë duhet të vepronin me shkathtësi dhe të kryenin detyra që zakonisht nuk përfshihen në mandatin e një fuqie mbrojtëse.

Një nga detyrat e para ishte riatdhësimi dhe kthimi i sigurt i diplomatëve dhe shtetasve amerikanë. U deshën gati dy vjet për të siguruar që të gjithë qytetarët amerikanë, të cilët donin të largoheshin, të mund ta bënin këtë të sigurt.

Ndërkohë, ndodhi kriza famëkeqe e raketave më 1962-shin, kur Presidentit Kennedy i duhej të mbështetej në të gjitha kanalet e mundshme të komunikimit për të shmangur goditjen nga ajri dhe një përshkallëzim të mundshëm që mund të sillte në luftën e tretë botërore.

Në këtë kohë, ambasadori zviceran në Havanë, Emil A. Stadelhofer, i



Përfaqësimi zviceran i interesave të SHBA-së në Kubë dhe gjithashtu i interesave kubane në SHBA, është mandati më i gjatë i një fuqie mbrojtëse në histori. Ajo që e bënte rolin zviceran të veçantë, ishte se ai kryhej në mes të frikërave të një lufte të re botërore; përfshinte situata urgjente dhe kërkonte aftësi dhe veprime të forta nga diplomatët zviceranë

cili kish ndërtuar një marrëdhënie të veçantë me Fidel Castro-n, luajti një rol të rëndësishëm në përcimin e mesazheve nga SHBA-ja tek udhëheqësi kuban.

Natën e 22 tetorit 1962, ambasadorit Stadelhofer iu caktua t'i shpjegonte Fidel Castro-s se avionët amerikanë të zbulimit, do të fluturonin mbi Kubë për të fotografuar dhe ata nuk duhej të qëllonin. Castro ra dakord dhe kështu u shmang një krizë madhore.

Por në shkurt 1964, energjia dhe mençuria e zyrtarëve zviceranë u vu përsëri në provë, kur regjimi kuban kërkoi të sekuestronte ndërtesën e ambasadës së SHBA-së dhe ta kthente atë në Ministrinë kubane të Peshkimit.

Kur ndodhi kriza famëkeqe e raketave më 1962-shin, Presidentit Kennedy i duhej të mbështetej në të gjitha kanalet e mundshme të komunikimit për të shmangur një përshkallëzim të mundshëm të situatës, ambasadori zviceran në Havanë, Emil A. Stadelhofer, i cili kish ndërtuar një marrëdhënie të veçantë me Fidel Castro-n, luajti një rol të rëndësishëm në përcimin e mesazheve nga SHBA-ja tek udhëheqësi kuban